

PKR.nr.756/13

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA – Kryetarja e trupit gjykues Shadije Gërguri me procesmbajtësin Arianit Mahmutaj në lëndën penale ndaj të akuzuarit H. H. për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.nr.873-1/2012 të dt.30.11.2012, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, verbal e publik me dt. **28.04.2017**, në prezencën e të akuzuarit H. H., dhe prokurorit të shtetit I. B., të njëjtën ditë e bjenë në prezencë të palëve publikisht shpallë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI:

H. H., nga i ati I., e ëma S., e gjinisë K., i lindur me dt. *data e lindjes...*, në f.sh. B. E., K-P., ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i tre fëmijëve, jo i punësuar, posedon fermë të dhinve dhe dhenve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës. Me nr persoanal *numri personal...*

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: me dt: 21.09.2011, rreth orës 17:30, në fshatin B. E. K-P., në pyllin-pronë e tij, për derisa ka vërejtur tre persona duke prerë dru me qëllim frikësimi, me armën e markës Ekol 99, me numër serik EU-10121332 të kalibrit 9mm ka shtënë 3-4 herë ne ajër, me ç’rast gjatë kontrollimit të tij nga ana e policisë janë gjetur dhe konfiskuar edhe një karikator dhe 4 (katër) fishek për të cilët nuk i dihet prodhimi, të cilat i mbante pa lejen valide.

-me çka ka kryer veprën penale: Mbajtja në pronësi ,në kontrollë ,në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së.

Andaj gjykata me aplikimin e neneve 3,41,42,43,46,62,73 të KPRK-së dhe nenit 365 dhe 450 të KPPRK-së.

Të akuzuarit H. H.it për veprën penale: Mbajtja në pronësi ,në kontrollë ,në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328.par.1.të KPK-ës , i shqiptoi **DENIM ME GJOBË** në shumën prej **400 € (katërqind euro)** , të cilën shumë i njejtë është i obliguar ta paguajë në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të realizohet as me detyrim konform nenit 46 par.3 të KPPK-së, gjykata këtë dënim me gjobë do ta zëvendësoj me dënim burgu konform nenit 46 par.3 të KPPK-së, ashtu që 20 € (njëzet) euro, të dënimit të shqiptuar llogaritet me një ditë burgim.

MBI DENIMIN PLOTËSUES

Konform nenit 62 par.2 nën.par.2.7 të KPK-së ndaj të akuzuarit H. H. i konfiskohet arma e markës Ekol 99 , të kalibrit 9mm, me numër serik- EV-10121332, një (1) karikator, dhe katër (4) fishek me gas të kalibrit 9mm,

I akuzuari H. H. obligohet të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë të kësaj gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej nga **50 € (pesëdhjetëdhjet) Euro**, në afat prej 15 (pesëmbëdhjet) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për krime të rënda ka ngritur aktakuzë PP.nr.873-1/2012 ,me dt.30.11.2012, kundër të akuzuarit H. H. për shkak të veprës penale: Mbajtja në pronësi,në kontrollë, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328.par.1.te KPK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestarë me datën 28.04.2017, dhe pasi që i akuzuari është njoftuar me të drejtat e tij në kuptim të nenit 246 të KPPK-së, ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën, nuk ka nevojë për shënim shtesë dhe pasi i ipet mundësia që të pranoj, ose mos te pranoj fajësinë lidhur me veprën penale që i vëhet në barrë, i akuzuari në kuptim të nenit 246 të KPPK-së, deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën e ngarkon aktakuza nga ana e prokurorisë.

Prokurori i shtetit pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Gjykata e aprovoi pranimin e fajësisë pasi që u bind se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht dhe pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza, në materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabime faktike.

Duke marr parasyshë se pranimit i fajësisë është arritur në shqyrtimin fillestarë konform nenit 246 par.1 dhe 2 të KPPK-së kur kryetarja e trupit gjykues mundë të vazhdon procedurën me shqiptimin e denimit pa shkuar fare në shqyrtim gjyqësorë dhe pa e plotësuar trupin gjykues, gjykata pa fjalë përfundimtare, pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe pasi që bindet se janë vërtetuar faktet lidhur me pranimin e fajësisë, të njejtën ditë vazhdoi me shqiptimin e denimit, duke marr parasyshë se i akuzuari veprën penale e ka kryer me dashje direkte, ka qenë i vetëdijshëm për veprën e tij.

Me rastin e përcaktimit të denimit Gjykata pati parasyshë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e denimit, kështu që ndaj të akuzuarit morri parasyshë pranimin e fajësisë dhe pendimin e thellë, ka të kryer shkollën e mesme, jo i punësuar, posedon fermë të dhive dhe dhenve, i martuar, baba i tre fëmijëve, gjendjes të mesme ekonomike më parë jo i gjykuar. Nga rrethanat rëndësuese asgjë nuk gjeti. Andaj gjykata të njejtin e shpalli fajtorë dhe e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se denimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës dhe përgjegjësisë penale dhe më të njejtën do të arrihet qëllimi i denimit .

Gjykata është e bindur se me denimin e shqiptuar në tërësi do të arrihet qëllimi i denimit siç është rregulluar me nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi denimin plotësues është marrur konform nenit 62 par.2 nën.par.2.7 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësorë, është marr konform dispozitave të nenit 450 par.2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Nga sa u cek me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.756/13, të dt. 28.04.2017

Procesmbajtësi,
Arianit Mahmutaj

Kryetarja e trupit - gjyqtarja,
Shadije Gërguri

KESHILLË JURIDIKE: Prokurori i shtetit dhe i akuzuari hoqën dorë nga e drejta në ankesë .